

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ZVA GROUP".**

Sot, me date 09 / 12 /2022 (dymije e njezete e dy), i pranishme:

- **Znj. Ornela Blea** shtetase Shqiptare, lindur në Vlore, më 23.08.1987, mbajtëse e leternjoftimit ID me numer personal I75823097H, me banim në Tirane, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z. Marini Veizi** shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, më 30.04.1986, mbajtës i leternjoftimit ID me numer personal I60430060L, me banim në Tirane, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

ne cilesine e ortakut te vetem themelues shpall hartimin dhe nenshkrimin e ketij Akt Themelimi ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si me poshte vijon:

**NENI 1
EMERTIMI**

Themelohet nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ZVA GROUP".

**NENI 2
SELIA**

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, ne adresen: Rruga Bardhyl; Nd. Progeen 2; H. 1; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 3; Njesia bashkiake nr. 3; 1005; Tiranë, Numri i banimit: 15 Kodi postal: 1015, Tirane, Shqiperi. Shoqeria, me vendim te Asamblese se pergjithshme te ortakeve, mund te hape seli dytesore, filiale, zyra perfaqesimi, dege ose agjensi si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj.


**NENI 3
KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare deri sa te mbyllet me akte ligjhore.

**NENI 4
OBJEKTI**

Objekti i Shoqerise eshte:

a) *Veprimtari në fushën e ndërtimit, projektimit, mbikëqyrjes, kolaudimit, restaurimit, vleresime, ekspertiza, trajnimi, certifikimi per objekte civile, industriale, monumentale, social*




kulturore, kulti dhe objekte te rendesise dhe sigurise se vecante. b) Studime urbanistike te te gjitha niveleve, planifikim urban. c) Studim projektim arkitektonik per te gjita llojet e objekteve te ndertimeve civile, industriale, sportive, social kulturore, agroperpunuese, turistike, peizash, interiere, portuale, aeroportuale, heliporte. d) Studim projektim te strukturave mbajtese beton-arme, metalike, druri. e) Studim projektim i objekteve me shkalle te larte veshitresie, si dhe ne troje me qendrushermeri te ulet. f) Studim projektim dhe sinjalizim rrugor ne rruge lokale, urbane dhe interurane, autostrada, superstarda dhe linja hekurudhore, sheshe, parkime, porte, aeroporte, heliporte. g) Studim projektim linjash dhe sistemesh te prodhimit dhe shperndrjes te energjise elektrike. h) Projektim per instalime hidrosanitare dhe termoteknike, ventilim kondicionim. i) Projektim per furnizim me uje, kolektore shkarkimi, ujesjelles kanalizime rurale-urbane, vepra ujitje, kullime, impiante vaditese, dampa, diga. j) Projektim per vepra hidroteknike, ura dhe vepra arti, ura metalike, ura druri, tunele rrugore dhe hekurudhore. k) Projektim i veprave naftsjellose, gazsjellose etj. l) Studime topografike, fotogrametrike, hartografike, GIS. m) Studime dhe projektme hidrogeologjike dhe te shpateve te buta, studim/vleresim gjeologjiko-inzhinierik per truallin e objekte deri dhe mbi 5 kat, si dhe truallit te objekteve te medha H/C, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa te medha. n) Sherbime te Auditimit te Energjise per godina banimi dhe sherbimi, godina industriale, godina te rendesises strategjike, ESCO, energjise se rinovueshme etj. o) Konsulence tekniko-ligjore sipas kategorive dhe nenkategorive te licencave profesionale te cdo lloj studimi dhe projektimi qe nuk jane cituar me siper. p) Ndertimi, rehabilitim dhe rikonstruksion objektesh te ndryshme me funksion civil sherbimesh dhe / ose banimi si dhe industrial, dhe monumente arkitekture te kategorive te ndryshme. q) Shërbime ligjore. r) Studime fizibiliteti. s) Zhvillimi, tjetërsimi dhe vleresimi i pasurive të paluajtshme. t) Ristrukturim të bizneseve në vështirësi, këshillime dhe asistencë në marrëdhëniet me institucionet financiare, këshillime dhe bashkëpunime me dhe për sektorin public. u) Veprimtari në fushën e turizmit, bar-restorant, hotel etj. v) Analiza dhe vleresime te biznesit, keshillime mbi transaksionet e shitjeve dhe analiza mbo strategjine e shitjeve, keshillime risku, keshillimi mbi vleresimin e aseteteve te kompanise dhe te aseteteve njerezore, keshillime dhe asistence ne hartimin e raporteve vjetore te kompanive. w) Import-eksport, ne fushen e karburanteve, vajrave lubrifikante etj. x) Marrja pjesë në shoqëri e në konsorciume të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. y) Tregti me shumicë dhe pakicë e produkteve dhe mallrave të ndryshme. z) Eksport dhe import i produkteve ushqimore dhe industrial. aa) Ushtrimi i veprimtarisë së marketingut. bb) Kryerja e çdo aktiviteti të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promocial apo dorezanes qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000 ALL (nje mije leke) dhe eshte i perbere nga 2 (dy) kuota si

me poshte:

- 1 (nje) kuote qe perfaqeson 33.4 % (tridhjetë e tre pike kater perqind) do te zoterohet nga **Znj. Ornela Bleta** shtetase Shqiptare, lindur në Vlore, më 23.08.1987, mbajtëse e leternjoftimit ID me numer personal I75823097H, me banim në Tirane, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- 1 (nje) kuote qe perfaqeson 66.6 % (gjashtedhjetë e gjashtë pike gjashtë perqind) do te zoterohet nga **Z. Marini Veizi** shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, më 30.04.1986, mbajtës i leternjoftimit ID me numer personal I60430060L, me banim në Tirane, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

NENI 6 ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane Asambleja e pergjithshme dhe organi administrativ. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise dhe vepron ne perputhje me statutin e shoqerise dhe ligjet ne fuqi.

Organi i vetem Administrativ i shoqerise eshte Administratori:

- Z. Marini Veizi shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, më 30.04.1986, mbajtës i leternjoftimit ID me numer personal I60430060L, me banim në Tirane, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të veprua; qe do te qendroje ne detyre per nje periudhe prej 5 vjetesh me te drejte rizgjedhjeje.

Ne rastin e me shume se nje administratori:

Pervec procedurave te nevojshme per rregjistrimin e kesaj shoqerie dhe deklarimiin e ortakut perfitues, ne rast se shoqeria do te kete me shume se nje administrator asnje veprim nuk mund te kryhet nga Administratori i Dyte pa miratimin me shkrim te Administratorit te Pare. Administratori i Pare nuk ka asnje kufizim ne administrimin e zakonshem te shoqerise.


Ne rastin e Administratorit te vetem:

Administratori ka te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem te shoqerise, ne perputhje me sa parashikohet nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga statuti i shoqerise. Administratori ka te drejta dhe kompetenca te plota per kryerjen e te gjitha veprimeve qe do te konsideroje te dobishme per realizimin e objektiveve te shoqerise, me perjashtim te atyre qe kerkojne miratimin paraprak te Asamblese se pergjithshme.

Administratori perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet, perpara organeve shteterore dhe private.

NENI 7 PJESEMARRJA NE SHOQERI TE TJERA

Ortaket mund te vendosin lirisht pjesemarrjen ne shoqeri te tjera si dhe te fillojne çdo lloj aktiviteti tjetër tregtar ne territorin e Shqiperise, me kushtin qe te mos jete konkurues me ate te shoqerise se themeluar prej tyre.



Cdo veprimtari qe bie ndeshe me paragrafin e siperpermendur nuk do te konsiderohet si konflikt interesi nese mer votbesimin e te pakten 70% (shtatëdhjete perqindë) te ortakeve. Do te konsiderohen te perjashtuara nga kufizimi i mesiperm marredheniet dhe veprimtarite tregtare qe mund te ushtrohen prej ortakeve jashte Republikes se Shqiperise.

NENI 8
LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat e statutit te shoqerise, si dhe nga te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndermjet ortakeve ose ndermjet ortakeve dhe shoqerise dhe qe ka lidhje me te drejta te disponueshme ne lidhje me marredheniet e tyre me shoqerine do t'i drejtohen per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 10
DISPOZITA FINALE

Ky akt themelimi u hartua ne kater kopje te njejta ne gjuhen shqipe, u lexua e u pranua nga ortaku i shoqerise, i cili e nenshkruan per te gjitha efektet e ligjit.

ORTAKET THEMELUES

Moriri Xhira



Donela Bleta

MB